

# **IKAF AC-P1 Kontabilisti Profesional (Qeverisja,Risku dhe Etika)**

## **Syllabus dhe Udhëzues Studimi**

*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

### **Struktura e Kualifikimit**

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Kontabilisti Profesional. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

### **Moduli**

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregojnë në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojnë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

### **Struktura e Syllabusit**

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Kontabilisti Profesional i cili është pjesë e nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

### **Udhëzuesi i Studimit**

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuar në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.

## STRUKTURA E KUALIFIKIMIT


*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Auditori i Certifikuar fillimisht duhet të kualifikohet si Kontabilist i Certifikuar në IKAF. Jo për të gjithë Kontabilistët e Certifikuar kërkohet ose është e nevojshme të kualifikohen Auditor të Certifikuar, me përjashtim të rastit nëse ata zgjedhin një karrierë në ofrimin e auditimeve ligjore dhe shërbimeve përkatëse. Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) licencon

Auditorët në Kosovë dhe roli i IKAF-it është për të siguruar se ata janë të certifikuar në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Edukimit, Direktivën e 8 të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në vitet e fundit standardet e edukimit dhe kërkesat e praktikës profesionale për

Auditorët Ligjor janë përditësuar, andaj skema e re e kualifikimit në IKAF ka për qëllim të sigurojë që auditorët e Kosovës janë të kualifikuar me standardet më të larta ndërkombëtare. Për të u trajnuar për kualifikim si Auditor i Certifikuar, ju së pari duhet të jeni anëtar i IKAF dhe të keni përfunduar kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar. Anëtarësia në këtë nivel është e hapur për të gjithë profesionistët që punojnë në kontabilitet dhe auditim dhe të cilët kanë përfunduar nivelin për Kontabilist të Certifikuar.

Kandidatët në Kualifikimin për Auditor i Jashtëm i Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën “Kontabilisti Profesional”.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Auditor i Jashtëm i Certifikuar

## Modulet

Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Auditor i Jashtëm i Certifikuar

### **KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE ANETARESIMIT: Auditor i Jashtëm i Certifikuar**

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Kontabilistë të Çertifikuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës 3 vite në auditim apo kontabilitet;
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Auditori i Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Auditori i Çertifikuar” e kane obligative ndjeken e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore

### **Karakteristikat e ligjerates trajnuese:**

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve, dhe gjatë ligjerates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjeruesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

# **STRUKTURA E SYLLABUSIT**

## **Arsyetimi**

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

## **Diagrami i relacioneve mes moduleve**

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

## **Qëllimi**

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

## **Aftësitë kryesore**

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

## **Temat**

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

## **Struktura e Ekzaminimit**

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

## **Shtojcë Syllabusi i Detajuar**


Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

# MODULI

## Arsyetimi

Plan-programi për Provimin P1, Kontabilisti Profesional (Qeverisja, risku dhe etika) vepron si portë hyrës në nivelin profesional. Ai i vë provimet tjera bazë dhe opcionale në një kontekst më të gjerë profesional, organizativ dhe shoqëror.

Plan-programi konsideron njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara në nivelin Bazë ku janë marrë shkathtësitë teknike kryesore dhe ku etika, qeverisja korporative, auditimi i brendshëm, kontrolli dhe rreziku janë prezantuar në një kontekst specifik në lidhje me lëndën e trajtuar.



Diagrami.1.: Nderlidhjet mes moduleve

Plan-programi fillon me shqyrtimin e tërë fushës së qeverisjes brenda organizatës në kontekstin e gjerë të marrëdhënies së agjensisë. Ky aspekt i plan-programit përqendrohet në rolet përkatëse dhe përgjegjësitë e drejtuesve dhe zyrtarëve ndaj akterëve organizativ dhe të kontabilitetit dhe auditimit si funksione mbështetëse dhe kontrolluese. Më pas, plan-programi eksploron rishikimin e brendshëm, kontrollin dhe rezultatet për të zbatuar dhe mbështetur qeverisjen efektive, përfshirë çështjet e pajtueshmërisë në lidhje me vendim marrjen dhe funksionet mbështetëse të marrjes së vendimit. Gjithashtu, plan-programi shqyrton tërë fushën e identifikimit, vlerësimit dhe kontrollimit të rrezikut si aspekt kyç i menaxhmentit të përgjegjshëm. Në fund, plan-programi mbulon etikën personale dhe profesionale, kornizat etike – dhe vlerat profesionale – siç aplikohet në kontekstin e detyrave të kontabilistit dhe si udhëzues për sjellje profesionale të duhur dhe veprim në situata të ndryshme.

## Qëllimi

Përdorimi i njohurive përkatëse, aftësive dhe ushtrimi i gjykimit profesional gjatë kryerjes së detyrës së kontabilistit në lidhje me qeverisjen, kontrollin e brendshëm, pajtueshmërinë dhe menaxhimin e rrezikut brenda organizatës, në kontekstin e një kornize të përgjithshme etike.

## Aftësitë kryesore

- Përkufizojnë qeverisjen dhe shpjegojnë funksionin e saj në menaxhimin efektiv dhe kontrollin e organizatave dhe burimeve për të cilat ata përgjegjës

- Vlerësojnë rolin e Qeverisjes, rrezikut dhe etikës në kontrollin e brendshëm, rishikimin dhe pajtueshmërinë
- Shpjegojnë rolin e kontabilistit në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut
- Shpjegojnë dhe vlerësojnë rolin e kontabilistit në kontrollimin dhe zvogëlimin e rrezikut
- Demonstrjnë aplikimin e vlerave dhe gjykimit profesional përmes një kornize etike që mbron interesat më të mira të shoqërisë dhe profesionit, në pajtueshmëri me kodet përkatëse profesionale, ligjet dhe rregulloret.

## Temat

Temat kryesore të Modulit Kontabilisti Profesional që do të trajtohen gjatë ligjerates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Kontabilisti Profesional

## Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

## Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i detajua

# Syllabusi i Detajuar

## 1 Qeverisja dhe përgjegjësia

- 1.1 Objekti i qeverisjes
- 1.2 Marrëdhëniet e agjensisë dhe teoritë
- 1.3 Bordi i drejtuesve
- 1.4 Komitetet e bordit
- 1.5 Kompensimi i drejtuesve
- 1.6 Qasje të ndryshme ndaj qeverisjes korporative
- 1.7 Qeverisja korporative dhe përgjegjësia shoqërore e korporatës
- 1.8 Qeverisja: raportimi dhe shpalosja

## 2 Kontrolli i brendshëm dhe rishikimi

- 2.1 Sistemet e kontrollit të menaxhmentit në qeverisjen korporative
- 2.2 Kontrolli i brendshëm, auditimi dhe pajtueshmëria në qeverisjen korporative
- 2.3 Kontrolli i brendshëm dhe raportimi
- 2.4 Informatat e menaxhmentit në auditim dhe kontroll të brendshëm

## 3 Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut

- 3.1 Rreziku dhe procesi i menaxhimit të rrezikut
- 3.2 Kategoritë e rrezikut
- 3.3 Identifikimi, vlerësimi dhe matja e rrezikut

## 4 Kontrollimi i rrezikut

- 4.1 Përcaktimi dhe monitorimi i rrezikut
- 4.2 Metodatat e kontrollimit dhe zvogëlimit të rrezikut
- 4.3 Mënjanimi, mbajtja dhe modelimi i rrezikut

## 5 Vlerat profesionale dhe etika

- 5.1 Teoritë mbi etikën
- 5.2 Qasje të ndryshme mbi etikën dhe përgjegjësinë shoqërore
- 5.3 Profesionet dhe interesi publik
- 5.4 Praktika profesionale dhe kodet e etikës
- 5.5 Konfliktet e interesit dhe pasojat e sjelljes jo etike
- 5.6 Karakteristikat etike të profesionalizmit
- 5.7 Çështjet shoqërore dhe mjedisore në udhëheqjen e biznesit dhe sjellje etike

# Udhëzues Studimi

## 1 Qeverisja dhe përgjegjësia

### 1.1 Objekti i qeverisjes

- a) Përkufizoni dhe shpjegoni kuptimin e qeverisjes korporative [2]
- b) Shpjegoni dhe analizoni çështjet e ngritura nga zhvillimi i kompanive aksionare si formë dominante e organizatës biznesore dhe ndarjen e pronësisë dhe kontrollit përgjatë zhvillimit të aktivitetit biznesor.
- c) Analizoni qëllimet dhe objektivat e qeverisjes korporative.
- d) Shpjegoni dhe aplikoni në kontekstin e qeverisjes korporative, konceptet mbështetëse kryesore të:
  - o Paanësisë
  - o të qenurit i hapur/transparencës
  - o pavarësisë
  - o moralit/ndershmërisë
  - o përgjegjësisë
  - o llogaridhënies
  - o reputacionit
  - o gjykimit
  - o integritetit
- e) Shpjegoni dhe vlerësoni fushat kryesore të jetës organizative të ndikuar nga çështjet e qeverisjes korporative.
  - o detyrat e drejtuesve dhe funksionet e bordit (përfshirë matjen e performancës)
  - o përbërja dhe bilanci i bordit(dhe komitetet e bordit)
  - o besueshmëria e raportimit financiar dhe auditimi i jashtë
  - o kompensimi i drejtuesve dhe shpërblimet
  - o përgjegjësia e bordit në sistemet e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollin e brendshëm
  - o të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve, përfshirë investitorët institucional
  - o përgjegjësia shoqërore e korporatës dhe etika në biznes.
- f) Krahasoni dhe bëni dallimin mes sektorëve publik, privat dhe organizatave jo qeveritare

(OJQ) në lidhje me çështjet e ngritura nga dhe brenda objektit të qeverisjes.

- g) Shpjegoni dhe vlerësoni rolet, interesat dhe kërkesat e palëve të brendshme të përfshira në qeverisjen korporative
  - o Drejtuesve
  - o Sekretarëve të kompanisë
  - o Menaxhmentit të nën-bordit
  - o Përfaqësuesve të punonjësve (p.sh. unionet tregtare)
- h) Shpjegoni dhe vlerësoni rolet, interesat dhe kërkesat e palëve të jashtme të përfshira në qeverisjen korporative [3]
  - o Aksionarëve (përfshirë të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve) (ii) Auditorëve
  - o Rregullatorëve
  - o Qeverisë
  - o Bursave të këmbimit
  - o Investitorëve të vegjël (dhe të drejtat e minoriteteve)
  - o Investitorëve institucional (shiko edhe pikën vijuese)
- i) Analizoni dhe diskutoni rolin dhe influencën e investitorëve institucional në sistemet dhe strukturat e qeverisjes korporative, për shembull rolin dhe influencën e fondeve pensionale, të kompanive të sigurimit dhe fondeve të përbashkëta.[2]

### 1.2 Marrëdhëniet e agjensisë dhe teoritë

- a) Përkufizoni dhe shqyrtoni teorinë e agjensisë
- b) Përkufizoni dhe shpjegoni konceptet kyçe në teorinë e agjensisë.[2]
  - o Agjentët
  - o Kryesorët
  - o Agjensia
  - o Kostot e agjensisë
  - o Llogaridhënia
  - o Përgjegjësitë në mirëbesim
  - o Akterët



- c) Shpjegoni dhe shqyrtoni natyrën e marrëdhënies kryesor - agjent në kontekstin e qeverisjes korporative.[3]
- d) Analizoni dhe vlerësoni në mënyrë kritike natyrën e llogaridhënies së agjensisë në marrëdhëniet në agjensi.[3]
- e) Shpjegoni dhe analizoni teoritë tjera në vijim të përdorura për të shpjeguar aspektet e marrëdhënieve të agjensisë .
  - o Teoria e kostove të transaksionit
  - o Teoria e akterëve

### 1.3 Bordi i drejtuesve

- a) Shpjegoni dhe vlerësoni rolet dhe përgjegjësitë e bordeve të drejtorëve.[3]
- b) Përshkruani, bëni dallimin dhe vlerësoni rastet për dhe kundër strukturave të bordit të vetëm dhe bordit me dy nivele.[3]
- c) Përshkruani karakteristikat, përbërjen e bordit dhe llojet e drejtorëve (përfshirë përkufizimin e drejtorëve ekzekutiv dhe jo ekzekutiv - DJE (NED)[2]
- d) Përshkruani dhe vlerësoni qëllimet, rolet dhe përgjegjësitë e NED.[3]
- e) Përshkruani dhe analizoni parimet e përgjithshme të kornizave ligjore dhe rregullative brenda të cilave operojnë drejtuesit në bordet e korporatës:[2]
  - o të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore, emërimet me kohë të caktuar
  - o pensionimi me rotacion,
  - o kontratat e shërbimit, (v) largimi,
  - o diskualifikimi
  - o konflikti dhe shpalosja e interesave
  - o marrëveshja / tregtimi i brendshëm
- f) Përkufizoni, shqyrtoni dhe krahasoni rolin e zyrtarit kryesor ekzekutiv dhe kryesuesit të kompanisë.[3]
- g) Përshkruani dhe vlerësoni rëndësinë dhe zbatimin e qasjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të drejtuesve në bordet e drejtorëve.[3]
- h) Shpjegoni dhe analizoni kornizat për vlerësimin e performancës së bordeve dhe drejtorëve individual (përfshirë NED) në borde.[2]

- i) Shpjegoni kuptimin e 'diversitet' dhe në mënyrë kritike vlerësoni çështjet e diversitetit në bordet e drejtuesve.[3]

### 1.4 Komitetet e bordit

- a) Shpjegoni dhe vlerësoni rëndësinë, rolet dhe përgjegjësitë e komiteteve të bordit në qeverisjen korporative.[3]
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni rolin dhe qëllimin e komiteteve vijuese në qeverisjen korporative efektive:[3]
  - o Komitetet për kompensim
  - o Komitetet për nominim
  - o Komitetet për rrezikun.
  - o Komitetet e auditimit

### 1.5 Kompensimi i drejtuesve

- a) Përshkruani dhe vlerësoni parimet e përgjithshme të kompensimit. [3]
  - o qëllimet
  - o përbërësit
  - o lidhjet me strategjinë
  - o lidhjet me kushtet e tregut të punës.
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni efektin e përbërësve të ndryshëm të paketave të kompensimit në sjelljen e drejtuesve. [3]
  - o paga bazë
  - o e lidhur me performancën
  - o aksionet dhe opsion aksionet
  - o bonuset për besnikëri (v) përfitimet e llojit të vet (vi) përfitimet pensionale
- c) Shpjegoni dhe analizoni çështjet ligjore, etike, kompetitive dhe rregullative që lidhen me kompensimin e drejtuesve.[3]

### 1.6 Qasje të ndryshme ndaj qeverisjes korporative

- d) Përshkruani dhe krahasoni pikat kryesore të qasjes bazuar në 'rregulla' dhe 'parime' në qeverisjen korporative. Përfshin diskutimin e 'pajtueshmërisë apo shpjegimit'. [3]
- e) Përshkruani dhe analizoni modelet e ndryshme të pronësisë biznesore që ndikojnë në administrime të ndryshme qeverisëse (p.sh.

firmit familjare kundrejt modeleve të kompanive aksionare).[2]

- f) Përshkruani dhe vlerësoni në mënyrë kritike arsyet pas zhvillimit dhe përdorimit të kodeve të praktikës në qeverisjen korporative (duke vënë në pah dallimet kombëtare dhe konvergjencën).[3]
- g) Shpjegoni dhe shkurtimisht shqyrtoni zhvillimin e kodeve të qeverisjes korporative në juridiksionet që bazohen në parime.[2]
  - o stimujt dhe e kaluara
  - o kodet kryesore të qeverisjes korporative
- h) Shpjegoni dhe shqyrtoni Aktin Sarbanes-Oxley (2002) si shembull i qasjes bazuar në rregulla ndaj qeverisjes korporative [2]
  - o (i) stimujt dhe e kaluara
  - o (ii) dispozitat/përmbajtja kryesore
  - o (iii) efektet e
- i) Përshkruani dhe shqyrtoni objektivat, përmbajtjen dhe kufizimet e kodeve të qeverisjes korporative që synohet të përdoren në juridiksione në shumë vende
  - o Raporti i Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik (OECD) (2004)
  - o Raporti i Rrjetit ndërkombëtar i qeverisjes korporative (ICGN) (2005)

### 1.7 Qeverisja korporative dhe përgjegjësia shoqërore e korporatës

- a) Shpjegoni dhe shqyrtoni përgjegjësinë shoqërore në kontekstin e qeverisjes korporative.[2]
- b) Diskutoni dhe vlerësoni në mënyrë kritike konceptin e aksionarëve dhe aksion-mbajtjes në organizata dhe mënyrës së ndikimit në strategjinë dhe qeverisjen korporative.[3]
- c) Analizoni dhe vlerësoni çështjet e ‘pronësisë,’ ‘pronës’ dhe përgjegjësi të pronësisë në kontekstin e aksionmbajtjes.[3]
- d) Shpjegoni konceptin e organizatës si korporatë-pjesë e shoqërisë me të drejta dhe përgjegjësi.[3]

### 1.8 Qeverisja: raportimi dhe shpalosja

- a) Shpjegoni dhe vlerësoni parimet e përgjithshme të shpalosjes dhe komunikimit me aksionarët.[3]
- b) Shpjegoni dhe analizoni kërkesat për shpalosje të ‘praktikave më të mira’ të qeverisjes korporative [2]
- c) Përkufizoni dhe bëni dallimin mes shpalosjeve të detyrueshme dhe vullnetare të informatave të korporatës në ciklin e zakonshëm të raportimit.[2]
- d) Shpjegoni dhe shqyrtoni natyrën dhe arsyet dhe motivimet për shpalosjet vullnetare në mjediset raportuese të bazuara në parime (për shembull, në krahasim me regjimin raportues në SHBA).[3]
- e) Shpjegoni dhe analizoni qëllimet e mbledhjes së përgjithshme vjetore dhe mbledhjeve të përgjithshme të jashtëzakonshme për këmbimin e informatave mes bordit dhe aksionarëve.[2]
- f) Përshkruani dhe vlerësoni rolin e votimit të autorizuar në qeverisjen e korporatave të brendshme

## 2 Kontrolli i brendshëm dhe rishikimi

### 2.1 Sistemet e kontrollit të menaxhmentit në qeverisjen korporative

- a) Përkufizoni dhe shpjegoni kontrollin e menaxhimit të brendshëm. [2]
- b) Shpjegoni dhe shqyrtoni rëndësinë e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut në qeverisjen korporative
- c) Përshkruani objektivat e sistemeve të kontrollit të brendshëm. [2]
- d) Identifikoni, shpjegoni dhe vlerësoni rolet e qeverisjes korporative dhe menaxhmentit ekzekutiv në menaxhimin e rrezikut (në veçanti ndarjen mes përgjegjësisë për sigurimin që sistemet adekuate të menaxhimit të rrezikut ekzistojnë dhe zbatimit sistemeve dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut në organizatë).[3]
- e) Identifikoni dhe vlerësoni rëndësinë e elementeve apo përbërësve të sistemeve të kontrollit të brendshëm.[3]

## 2.2 Kontrolli i brendshëm, auditimi dhe pajtueshmëria në qeverisjen korporative

- a) Përshkruani funksionin dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm [1]
- b) Shpjegoni dhe diskutoni rëndësinë e pavarësisë së auditorit në të gjitha situatat klient – auditor (duke përfshirë auditimin e brendshëm).[3]
- c) Shpjegoni dhe vlerësoni natyrën dhe burimet e rreziqeve ndaj pavarësisë së auditorit.
- d) Shpjegoni dhe vlerësoni rëndësinë e pajtueshmërisë dhe rolit të funksionit të

## 2.3 Kontrolli i brendshëm dhe raportimi

- a) Përshkruani dhe vlerësoni nevojën për raportimin mbi kontrollin e brendshme të aksionarët [3]
- b) Përshkruani përmbajtjen e raportit mbi kontrollin dhe auditimin e brendshëm.[2]
- c) Shpjegoni dhe vlerësoni se si kontrollin e brendshme mbështesin dhe ofrojnë informata për raportim financiar të saktë

## 2.4 Informatat e menaxhmentit në auditim dhe kontroll të brendshëm

- a) Shpjegoni dhe vlerësoni nevojën për rrjedhjen e informatave të duhura të menaxhmentit për qëllime të menaxhimit të kontrollit të brendshëm dhe rrezikut.
- b) Vlerësoni cilësitë dhe karakteristikat e informatave të nevojshme në kontroll të brendshëm dhe menaxhim dhe monitorim të rrezikut [3]

## 3 Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut

### 3.1 Rreziku dhe procesi i menaxhimit të rrezikut

- c) Përshkruani dhe shpjegoni rrezikun në kontekstin e qeverisjes korporative.[2]

auditimit të brendshëm në kontrollin e brendshëm [3]

- e) Shqyrtoni dhe vlerësoni efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm [3]
  - f) Përshkruani dhe analizoni punën e komitetit të auditimit të brendshëm në mbikëqyrjen e funksionit të auditimit të brendshëm [2]
  - g) Shpjegoni dhe shqyrtoni rëndësinë dhe karakteristikat e marrëdhënies së komitetit të auditimit me auditorët e jashtë
- d) Përshkruani dhe përshkruani përgjegjësitë e menaxhmentit në menaxhimin e rrezikut.[2]
  - e) Shpjegoni natyrën dinamike të vlerësimit të rrezikut.[2]
  - f) Shpjegoni rëndësinë dhe natyrën e përgjigjes së menaxhmentit ndaj ndryshimit të vlerësimeve të rrezikut.[2]
  - g) Shpjegoni oreksin për rrezik dhe si kjo ndikon në politikën e rrezikut.[2]

### 3.2 Kategoritë e rrezikut

- a) Përshkruani dhe krahasoni (bëni dallimin mes) rreziqeve strategjike dhe operacionale.[2]
- b) Përshkruani dhe shpjegoni burimet dhe ndikimet e rreziqeve të përbashkëta biznesore.[2]
  - o tregut
  - o kreditimit (iii) likuiditetit (iv) teknologjike (v) ligjore
  - o shëndetësore, të sigurisë dhe mjedisore
  - o reputacionit
  - o ndershmërisë në biznes
  - o derivativeve
- c) Përshkruani dhe vlerësoni natyrën dhe rëndësinë e rreziqeve financiare dhe biznesore [3]
- d) Njihni dhe analizoni natyrën specifike të sektorit apo industrisë të shumë rreziqeve biznesore.[2]

### 3.3 Identifikimi, vlerësimi dhe matja e rrezikut

- e) Identifikoni dhe vlerësoni ndikimin në aksionarët e përfshirë në rrezikun e biznesit.[3]

- f) Shpjegoni dhe analizoni konceptet e vlerësimit të rigozitetit dhe probabilitetit të ngjarjeve të rrezikut. [2]
- g) Përshkruani dhe vlerësoni një kornizë për nivelin e konsiderimit të rrezikut nga bordi. [3]
- h) Përshkruani procesin dhe rëndësinë e raportimit nga jashtë mbi kontrollin e brendshëm dhe rrezikun.[2]
- i) Shpjegoni burimet dhe vlerësoni rëndësinë e informatave të sakta për menaxhimin e rrezikut.[3]
- j) Shpjegoni dhe vlerësoni parimin e ALARP (sa më i ulët që është e praktikueshme në mënyrë të arsyeshme) në vlerësimin e rrezikut dhe se si kjo lidhet me rigozitetin dhe probabilitetin. [3]
- k) Vlerësoni vështirësitë e perceptimit të rrezikut përfshirë konceptet e perceptimit objektiv dhe subjektiv të rrezikut/
- l) Shpjegoni dhe vlerësoni konceptet e faktorëve të ndërlidhur dhe reciprok të rrezikut.[3]
- c) Përshkruani dhe vlerësoni konceptin e përfshirjes së rrezikut në kulturën dhe vlerat e organizatës [3]
- d) Shpjegoni dhe analizoni konceptet e përhapjes dhe diversifikimit të rrezikut dhe kur një gjë e tillë është e përshtatshme.[2]
- e) Identifikoni dhe vlerësoni si organizatat biznesore përdorin politika dhe teknika për zvogëlimin e llojeve të ndryshme të rreziqeve financiare dhe biznesore.

#### 4.3 Mënjanimi, mbajtja dhe modelimi i rrezikut

- a) Shpjegoni, dhe vlerësoni rëndësinë e, transferimit, mënjanimit, reduktimit dhe pranimit të rrezikut.
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni qëndrimet e ndryshme ndaj rrezikut dhe se si kjo mund të ndikojë në strategji.[3]
- c) Shpjegoni dhe vlerësoni domosdoshmërinë e marrjes së rreziqeve si pjesë e menaxhimit në mënyrë kompetitive të organizatës biznesore.[3]
- d) Shpjegoni dhe vlerësoni qëndrimet ndaj rrezikut dhe mënyrat në të cilat rreziku ndryshon në varësi të madhësisë, strukturës dhe zhvillimit të një organizate [3]

## 4 Kontrollimi i rrezikut

### 4.1 Përcaktimi dhe monitorimi i rrezikut

- a) Shpjegoni dhe vlerësoni rolin e menaxherit të rrezikut në identifikimin dhe monitorimin e rrezikut.[3]
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni rolin e komitetit për rrezikun në identifikimin dhe monitorimin e rrezikut.[3]
- c) Përshkruani dhe vlerësoni rolin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të rrezikut në monitorimin e rrezikut.[3]

### 4.2 Metodatat e kontrollimit dhe zvogëlimin të rrezikut

- a) Shpjegoni rëndësinë e vetëdijesimit mbi rrezikun në të gjitha nivelet në organizatë. [2]
- b) Përshkruani dhe analizoni konceptin e përfshirjes së rrezikut në sistemet dhe procedurat e organizatës.[3]

## 5 Vlerat profesionale dhe etika

### 5.1 Teoritë mbi etikën

- a) Shpjegoni dhe bëni dallimin mes teorive etike të relativizmit dhe absolutizmit.[2]
- b) Shpjegoni, në kontekstin e qeverisjes dhe kontabilitetit, fazat e zhvillimit të moralit njerëzor sipas Kohlberg.[3]
- c) Përshkruani dhe bëni dallimin mes qasjeve deontologjike dhe teleologjike / rezultuese ndaj etikës.[2]
- d) Aplikoni modelet e zakonshme të përdorura etike të vendim-marrjes në kontekstin profesional dhe të kontabilitetit [2]

## 5.2 Qasje të ndryshme mbi etikën dhe përgjegjësinë shoqërore

- a) Përshkruani dhe vlerësoni shtatë pozicionet e Gray, Owen & Adams (1996) mbi përgjegjësinë shoqërore. [2]
- b) Përshkruani dhe vlerësoni organizimet tjera të korporatës dhe qëndrimet etike personale: [2]
  - o interesat afat shkurta të aksionarëve
  - o interesat afat gjate të aksionarëve
  - o detyrimet e akterëve të shumëfishtë
  - o formuesi i shoqërisë
- c) Përshkruani dhe analizoni ndryshoret që përcaktojnë kontekstin kulturor të etikës dhe përgjegjësisë shoqërore të korporatës (CSR).[2]
- d) Shpjegoni dhe shqyrtoni natyrën e një 'profesioni' dhe 'profesionalizmi'. [2]
- e) Përshkruani dhe vlerësoni çfarë nënkupton 'interesi publik'. [2]
- f) Përshkruani rolin e kontabilitetit dhe vlerësoni influencën e gjithë-përhapur të tij si profesion në kontekstin organizativ. [3]
- g) Analizoni rolin e kontabilitetit si profesion në shoqëri. [2]
- h) Njihni rolin e kontabilitetit si profesion me peshë në gjendje të influencoj në shpërndarjen e fuqisë dhe pasurisë në shoqëri. [3]
- i) Përshkruani dhe në mënyrë kritike vlerësoni çështjet rreth kontabilitetit dhe që veprojnë kundër interesit publik.[3]

## 5.3 Profesionet dhe interesi publik

- a) Përshkruani dhe shqyrtoni fushat e sjelljes të shqyrtuara nga kodet etike të korporatës.
- b) Përshkruani dhe vlerësoni përmbajtjen dhe parimet pas kodeve profesionale të etikës

## 5.7 Karakteristikat etike të profesionalizmit

- a) Shpjegoni dhe analizoni përmbajtjen dhe natyrën e vendim-marrjes etike duke përdorë përmbajtje e kornizës së Kohlberg sipas nevojës[2]

- c) Përshkruani dhe vlerësoni kodet e etikës relevante për profesionistët e kontabilitetit si KF NK apo kodeve të trupave profesionale. [3]

## 5.4 Praktika profesionale dhe kodet e etikës

- a) Përshkruani dhe vlerësoni çështjet e ndërlidhura me konfliktet e interesit dhe zgjidhjen e konflikteve etike.[3]
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni natyrën dhe ndikimin e kerconimeve etike dhe masat mbojtese
- c) Shpjegoni dhe shqyrtoni se si kërcënimet ndaj pavarësisë mund të ndikojnë në sjelljen etike.[3]
- d) Shpjegoni dhe shqyrtoni 'marrjen e mitos' dhe korrupsionit' në kontekstin e qeverisjes korporative dhe vlerësoni se si kjo mund ta dëmtoj konfidencën dhe besimin.[3]

## 5.5 Përshkruani dhe vlerësoni praktikat më të mira të masave të ndërmarra për reduktimin dhe luftimin e mito-marrjes dhe korrupsionit dhe pengesave të zabtimit të masave të tilla

## 5.6 Konfliktet e interesit dhe pasojat e sjelljes jo etike

- a) Shpjegoni dhe analizoni përmbajtjen dhe natyrën e vendim-marrjes etike duke përdorë përmbajtje e kornizës së Kohlberg sipas nevojës[2]
- b) Shpjegoni dhe analizoni çështjet që lidhen me zbatimin e sjelljes etike në kontekstin profesional
- c) Përshkruani dhe diskutoni qasjet 'bazuar në rregulla' dhe 'bazuar në parime' për zgjidhjen e dilemave etike që hasen në kontabilitetin profesional
- b) Shpjegoni dhe analizoni çështjet që lidhen me zbatimin e sjelljes etike në kontekstin profesional
- c) Përshkruani dhe diskutoni qasjet 'bazuar në rregulla' dhe 'bazuar në parime' për

zgjidhjen e dilemave etike që hasen në

kontabilitetin profesional

### **5.8 Çështjet shoqërore dhe mjedisore në udhëheqjen e biznesit dhe sjellje etike**

- a) Përshkruani dhe vlerësoni efektet shoqërore dhe mjedisore që aktiviteti ekonomik mund të ketë (për sa i përket "gjurmëve" mjedisore dhe shoqërore dhe raportimit mjedisor).[3]
- b) Shpjegoni dhe vlerësoni konceptin e qëndrueshmërisë dhe vlerësoni çështjet në lidhje me kontabilitetin e qëndrueshmërisë (përfshir kontributin e kontabilitetit të "kostos së plotë").[3]
- c) Përshkruani karakteristikat kryesore të sistemeve të brendshme menaxheriale për mbështetjen e kontabilitetit mjedisor si EMAS dhe ISO 14000.[1]
- d) Shpjegoni dhe vlerësoni përmbajtjen tipike të një raporti shoqëror dhe mjedisor, dhe diskutoni dobinë e këtyre informatave për palët e përfshira.[3]
- e) Shpjegoni natyrën e auditimit shoqëror dhe mjedisor dhe vlerësoni kontributin që ai mund të japë në zhvillimin e kontabilitetit mjedisor

